



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS, AMBASADORIT EUGEN WOLLFARTH,
NË TAKIMIN E PËRVITSHËM PËR PARANDALIMIN DHE LUFTËN NDAJ
KULTIVIMIT TË BIMËVE NARKOTIKE**

11 prill 2013

Ministër Noka,
Ambasador Gaiani,
Drejtor i Përgjithshëm Burgaj,
Kryetarë bashkish dhe komunash,
Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni të theksoj se ky Takim i Përvitshëm për Parandalimin dhe Luftën ndaj Kultivimit të Bimëve Narkotike është një ngjarje domethënëse, kushtuar adresimit të një problemi real dhe të ngutshëm.

Prandaj, jam shumë i kënaqur që jam këtu me ju sot, në cilësinë time si Kryetar i Prezencës së OSBE-së. Dhe dëshiroj t'ju falënderoj ju, Ministër Noka, që e konsideroni këtë temë – luftën ndaj narkotikëve të paligjshëm – si kryefjalë të veprimeve të ministrisë suaj. Liderhipi juaj në luftën kundër narkotikëve të paligjshëm ka një rëndësi të madhe.

Diçka tjetër që duket, por që, prapëseprapë, vlen të theksohet: Zoti Ministër, ministria juaj dhe të gjithë zyrtarët e organeve të zbatimit të ligjit mund të kenë besim tek mbështetja jonë e vazhdueshme.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, duke vepruar në përputhje të plotë me mandatin e saj, mbetet e gatshme të asistojë Ministrinë e Brendshme dhe Policinë e Shtetit.

Për shumë vite, kultivimi i bimëve narkotike ka qenë problem në Shqipëri për arsye të ndryshme, përfshirë edhe tri arsyet e mëposhtme, të cilat minojnë që të gjitha shtetin e së drejtës:

- Kultivimi i bimëve narkotike zhvendos shumë kohë dhe energji nga veprimtaritë e ligjshme.
- Kultivimi i lëndëve narkotike të paligjshme gjeneron trafik dhe të ardhura të jashtëligjshme.
- Kultivimi i lëndëve narkotike të paligjshme çon në konsumimin e drogës dhe të gjitha problemet e tjera që lidhen me të.

Përveç rëndësisë së vetë temës – përdorimi i të gjitha energjive për të garantuar shtetin e së drejtës, unë e mbështes plotësisht qasjen tuaj sa u përket dy pikave kryesore:

- Të konsideruarit e parandalimit dhe luftës si dy përpjekje që shkojnë krah për krah. Kjo ka një rëndësi të veçantë: të sigurosh vazhdimësi mes dy anëve të të njëjtave veprime të përgjithshme, duke synuar në fund të njëjtin objektiv – shtetin e së drejtës.

- Vlerësimi se asgjë nuk mund të arrihet pa përfshirjen e qeverisë vendore. Ndonëse Policia e Shtetit mund të bëjë shumë, ajo nuk mund të punojë e vetme pa mbështetjen dhe partneritetin e autoriteteve vendore.

Nga pikëpamja operationale, fitorja mund të arrihet duke marrë në konsideratë të gjitha metodat e ndryshme dhe mjetet e mundshme që parashikon ligji.

Ky është qëllimi që duhet arritur: një Shqipëri pa kultivim dhe shpërndarje të bimëve të paligjshme narkotike.

Në Shqipëri, si kudo gjetkë, kultivimi i bimëve të paligjshme narkotike është krim dhe duhet të konsiderohet si i tillë në çdo moment, nga kushdo dhe nga të gjitha këndvështrimet e mundshme.

Parandalimi, frenimi, ulja dhe lufta ndaj këtij krimi në Shqipëri është një çështje me interes kombëtar.

Pavarësisht të gjitha përpjekjeve të ndërmarra deri tani nga Policia e Shtetit, ky problem ekziston dhe kultivimi i lëndëve të paligjshme narkotike ende nuk është çrrënjësuar. Në disa pjesë të vendit, ai mbetet një shqetësim i madh.

Kjo tregon qartë se Policia e Shtetit kërkon një bashkëpunim më të madh nga komuniteti dhe sistemi i drejtësisë penale, ndërkohë që ajo përpiqet të zbatojë një qasje policimi në komunitet për ta adresuar këtë problem. Të punuarit në partneritet është thelbësor.

Prandaj, i inkurajojmë të gjithë aktorët që të intensifikojnë bashkëpunimin e tyre në këtë fushë. Drogat e prodhuara në mënyrë të jashtëligjshme që vijnë nga Shqipëria nuk duhet të gjenden më në menyte e kafeneve të drogave të Evropës.

Ky bashkëpunim nuk është opion. Ai është detyrim – jo vetëm detyrim ligjor, por edhe një detyrim moral!

Ministër Noka,
Ambasador Gaiani
Drejtor i Përgjithshëm Burgaj,
Kryetarë e miq,

Më lejoni ta mbyll duke theksuar edhe një herë se Prezenca e OSBE-së në Shqipëri mbetet më se e gatshme ta inkurajojë dhe ta mbështesë më tej Policinë e Shtetit dhe pushtetin vendor për të nxitur dhe forcuar parandalimin dhe luftën ndaj kultivimit të bimëve narkotike të jashtëligjshme.

Në fund, dëshiroj t'ju shpreh të gjithëve urimet më të mira për vete dhe për punën tuaj të përditshme në përballje me këtë sfidë të madhe!

Faleminderit!